“(6) За градбите наменети за индивидуално домување со бруто развиена површина до 300 м2 не се врши технички преглед, а изведувачот е должен да даде изјава заверена кај нотар под полна материјална и кривична одговорност со која ќе потврди дека објектот е изграден во согласност со одобрението за градење и основниот проект или проектот на изведена состојба. Изјавата со која се потврдува дека објектот е изграден во согласност со одобрението за градење и основниот проект или проектот на изведена состојба се доставува до општината каде што е изграден објектот заедно со геодетски елаборат од извршен премер на објектот и доказ за платени трошоци за запишување на објектот во јавните книги на недвижности согласно со пресметката од членот 59 став (15) на овој закон.“

Член 48

Во членот 90 став (2) пред алинеја 1 се додава нова алинеја, која гласи:

“- дали градбата е изградена согласно основниот проект или проектот на изведена состојба и одобрението за градење,“.

Ставот (3) се менува и гласи:

“Надзорниот инженер кој врши технички преглед за градбите од втора категорија од членот 57 на овој закон, во извештајот за извршен технички преглед констатира дали градбата е изградена согласно со основниот проект или проектот на изведена состојба и одобрението за градење дали градбата е со фасада и може да се употребува, дали има одредени недостатоци кои мора да бидат отстранети и дали има одредени недостатоци кои ги нарушуваат основните барања на градбата кои се однесуваат на механичката отпорност, стабилност и сеизмичка заштита поради кои градбата не може да се стави во употреба.“

Член 49

Членот 91 се менува и гласи:

“Изведувачот е должен на денот на одржување на техничкиот преглед, на комисијата од членот 89 на овој закон односно на надзорниот инженер кој треба да изврши технички преглед да ја даде на увид целокупната документација наведена во членот 86 на овој закон.“

Член 50

По членот 92 се додава нов член 92-а, кој гласи:

“Член 92-а

(1) Постапката за поврзувањето на објектот со водоводна и канализациона мрежа ја спроведува единицата на локалната самоуправа на чие подрачје е изграден објектот.

(2) Објект кој е изграден без одобрение за градење не може да се поврзе за техничката инфраструктура (електроенергетска, водоводна, канализациона, патна и слично).

(3) Општината е должна да ја започне постапката за поврзување на објектот со водоводна и канализациона мрежа во рок од три работни дена од денот на приемот на одобрението за употреба за објектите од прва категорија од членот 57 на овој закон, извештајот за извршен технички преглед од надзорниот инженер за објектите од втора категорија од членот 57 на овој закон, односно изјавата од изведувачот за објектите за индивидуално домување со бруто развиена површина до 300 м².”

Член 51

Во членот 95 зборовите: “од страна на општината” се заменуваат со зборовите: “од страна на надзорниот инженер, односно по давање на изјава од изведувачот за објектите за индивидуално домување со бруто развиена површина до 300 м².”

Член 52

Членот 96 се менува и гласи:

„(1) Постапката за запишување на објектот во јавната книга на недвижности ја спроведува надлежниот орган од членот 58 на овој закон кој го издал одобрението за градење.

(2) За градбите од прва категорија органот на државната управа надлежен за вршење на работите од областа на уредување на просторот е должен во име и за сметка на инвеститорот да достави барање за запишување на градежниот објект во јавната книга на недвижности, до надлежниот орган за запишување на правата на недвижности, во рок од три работни дена од денот на приемот на геодетски елаборат за извршен премер на објектот и доказ за платени трошоци за запишување на објектот во јавните книги на недвижности од страна на инвеститорот согласно со пресметката од членот 59 став (15) на овој закон.

(3) За градбите од втора категорија од членот 57 на овој закон, општината е должна во име и за сметка на инвеститорот да достави барање за запишување на градежниот објект во јавната книга на недвижности, до надлежниот орган за запишување на правата на недвижности, во рок од три работни дена од денот на приемот на извештајот на надзорниот инженер со геодетски елаборат од извршен премер на објектот и доказ за платени трошоци за запишување на објектот во јавните книги на недвижности од страна на инвеститорот согласно со пресметката од членот 59 став (15) на овој закон.

(4) Надлежниот орган за запишување на правата на недвижности, градежниот објект ќе го запише во јавната книга на недвижности по поднесено барање од органите од ставовите (2) и (3) на овој член кон кое се поднесува основен проект или проект на изведена состојба доколку се извршени измени во текот на изградбата,

геодетски елаборат од извршен премер на објектот, како и одобрение за употреба за градбите од прва категорија од членот 57 на овој закон, извештај за извршен технички преглед од надзорен инженер за градбите од втора категорија од членот 57 на овој закон, односно изјава заверена од нотар дадена под полна материјална и кривична одговорност од изведувачот со која е потврдено дека објектот е изграден во согласност со одобрението за градење и основниот проект или проектот на изведена состојба, за градбите наменети за индивидуално домување со бруто развиена површина до 300 м².”

Член 53

Во насловот на Главата IX по зборовите: „архитекти и“ се додава зборот „овластени“.

Член 54

Во членот 102 став (1) по зборовите: „овластени архитекти и“ се додава зборот „овластени“.

Член 55

Во членот 129 ставот (2) се менува и гласи:

“Формата и содржината на образецот на легитимацијата и амблемот на градежниот инспектор и начинот на нејзиното издавање и одземање ги пропишува министерот кој раководи со органот на државната управа надлежен за вршење на работата од областа на уредување на просторот а на овластениот градежен инспектор градоначалникот на општината.”

Член 56

Во членот 130 став (1) зборовите: „пет години“ се заменуваат со зборовите: „три години“.

Во ставот (2) зборовите: „три години“ се заменуваат со зборовите: „две години“.

Член 57

По членот 130 се додава нов член 130-а, кој гласи:

“Член 130-а

(1) За работата на градежните инспектори на Државниот инспекторат за градежништво и урбанизам директорот на Државниот инспекторат за градежништво и урбанизам донесува годишна програма, а за работата на овластените градежни инспектори на општините и на општините во градот Скопје, годишна програма донесува градоначалникот на општината.

(2) Годишните програми од ставот (1) на овој член содржат месечни планови за работа на градежните, односно овластените градежни инспектори.

(3) Директорот на Државниот инспекторат за градежништво и урбанизам за работата на градежните инспектори најдоцна до 31 март во тековната година, доставува годишен извештај за претходната година, до Владата на Република Македонија, а градоначалникот на општината, односно општината во градот Скопје за работата на овластените градежни инспектори најдоцна до 31 март во тековната година, доставува годишен извештај за претходната година, до советот на општината.

(4) Годишните програми од ставот (1) на овој член се донесуваат до 31 декември во тековната година за наредната година.”

Член 58

Во членот 131 став (1) точката се заменува со записка и се додаваат зборовите: „како и при пренамена од станбен во деловен простор и обратно“.

Член 59

Во членот 134 став (3) зборовите: “ке го извести” се заменуваат со зборовите: “ке побара согласност”.

По ставот (3) се додава нов став (4), кој гласи:

“(4) Овластениот градежен инспектор доколку констатира дека сопственикот на посебниот дел од објект, станот или дел од станот извршил пренамена без одобрение за пренамена од членот 97 став (3) на овој закон, ќе донесе решение со кое ќе го задолжи сопственикот да го врати посебниот дел од објектот, станот или делот од станот во првобитна состојба.”

Член 60

Во членот 137 ставовите (2) и (3) се менуваат и гласат:

“(2) Против решението на градежен инспектор, како и против заклучокот со кој се дозволува извршување, заклучокот за прекинување на постапката и заклучокот за трошоците на извршувањето на постапката може да се изјави жалба до Комисија составена од три члена именувани од страна на министерот кој раководи со органот на државната управа надлежен за вршење на работите од областа на уредувањето на просторот. Претседателот на Комисијата е од редот на раководните државни службеници кој не бил вклучен во вршењето на инспекцискиот надзор.

(3) Против решението на овластениот градежен инспектор, како и против заклучокот со кој се дозволува извршување, заклучокот за прекинување на постапката и заклучокот за трошоците на извршувањето на постапката може да се изјави жалба до Комисија составена од три члена именувани од страна на градоначалникот на општината. Претседателот на Комисијата е од редот на раководните државни службеници кој не бил вклучен во вршењето на инспекцискиот надзор.”

Член 61

Во членот 138 став (2) зборовите: “и втора” се бришат, а зборовите: “трета, четврта и петта” се заменуваат со зборот “втора”.

Член 62

Во членот 142 став (2) зборовите: “и втора” се бришат, а зборовите: “трета, четврта и петта” се заменуваат со зборот “втора”.

Член 63

Во членот 143 став (1) зборовите: “и втора” се бришат, а зборовите: “трета, четврта и петта” се заменуваат со зборот “втора”.

Член 64

Во членот 145 став (2) точката на крајот од првата реченица се брише и се додаваат зборовите: “по конкретниот предмет за кој е утврдено неизвршување на работите.”

Во ставот (3) по зборовите: “од надлежност на овластениот градежен инспектор” се додаваат зборовите: “по конкретниот предмет за кој е утврдено неизвршување на работите”.

Член 65

Во членот 150 став (1) точки 1, 3, 4 и 5 зборовите: “втора и трета” се бришат.

Член 66

Во членот 151 став (1) точки 1, 2, 3 и 4 зборовите: “четврта и петта” се заменуваат со зборот “втора”.

Член 67

По членот 151 се додава нов член 151-а, кој гласи:

“Член 151-а

(1) Глоба во износ од 7.000 до 9.000 евра во денарска противвредност ќе му се изрече на правно лице - инвеститор ако не обезбеди обележување на проектираната градба на терен согласно со членот 82 на овој закон.

(2) Глоба во износ од 3.000 до 5.000 евра во денарска противвредност ќе му се изрече за прекршокот од ставот (1) на овој член и на одговорното лице во правното лице - инвеститор.

(3) Глоба во износ од 5.000 до 7.000 евра во денарска противвредност ќе му се изрече за прекршокот од ставот (1) на овој член и на физичко лице - инвеститор.”

Член 68

Во членот 156-а став (1) во воведната реченица зборовите: “втора и трета” се бришат.

Точката 2 се брише.

Точките 3, 4, 5 и 6 стануваат точки 2, 3, 4 и 5.

Член 69

Во членот 156-б став (1) во воведната реченица зборовите: “четврта и петта” се заменуваат со зборот “втора”.

Точката 2 се брише.

Точките 3, 4, 5 и 6 стануваат точки 2, 3, 4 и 5.

Член 70

Членот 157 се менува и гласи :

“Глоба во износ од 5000 до 7000 евра во денарска противвредност ќе му се изрече на инженер за изведба за прекршокот од членот 156 став (1) точки 2, 3, 4, 5, 6 и 8 на овој закон, прекршокот од членовите 156-а и 156-б на овој закон и доколку врши работи на раководење со изградбата без да има овластување за инженер за изведба согласно со членот 31 став (1) од овој закон.”

Член 71

Во членот 160 зборовите: “втора и трета” се бришат.

Член 72

Во членот 160-а зборовите: “четврта и петта” се заменуваат со зборот “втора”.

Член 73

Во членот 161 став (1) точка 1 сврзникот „и“ се брише.

По точката 1 се додава нова точка 2, која гласи:

„2) извршил пренамена од станбен во деловен простор и обратно, без издадено одобрение за пренамена (член 97 ставови (2) и (3)) и“.

Точката 2 станува точка 3.

Во ставот (2) зборовите: „точка 1“ се заменуваат со зборовите: „точки 1 и 2“.

Член 74

Во членот 162 став (1) бројот “170” се заменува со бројот “171”.

Член 75

Во членот 163 став (1) зборовите “став (8)” се заменуваат со зборовите “став (13)”.

По став (4) се додаваат четири нови става (5), (6), (7) и (8), кои гласат:

“(5) Глоба во износ од 3000 до 5000 евра во денарска противвредност ќе му се изрече за прекршок на одговорното лице и службеното лице во единицата на локалната самоуправа, како и во органот на државната

управа надлежен за вршење на работите од областа на уредување на просторот, ако во постапката за издавање на одобрение за градење постапат спротивно на членот 59 став (16) од овој закон.

(6) Глоба во износ од 5.000 до 7.000 евра во денарска противвредност ќе му се изрече за прекршок на функционерот кој раководи со органот, односно раководното лице на органот кој постапува по барањето за одобрение за градење доколку не постапат согласно со членот 59-ѓ од овој закон.

(7) Глоба во износ од 3.000 до 5.000 евра во денарска противвредност ќе му се изрече за прекршок на одговорното лице и службеното лице во единицата на локалната самоуправа доколку не постапат согласно со членот 92-а став (3) од овој закон.

(8) Глоба во износ од 3.000 до 5.000 евра во денарска противвредност ќе му се изрече за прекршок на одговорното лице и службеното лице во органот на државната управа надлежен за вршење на работите од областа на уредување на просторот доколку не постапат согласно со членот 96 став (2) од овој закон, односно на одговорното лице и службеното лице на единицата на локална самоуправа доколку не постапат согласно со членот 96 став (3) од овој закон.“

Преодни и завршни одредби

Член 76

Лиценцата А за проектирање издадена пред влегувањето во сила на овој закон продолжува да важи до истекот на рокот за кој е издадена и со истата ќе може да се врши проектирање на градби од прва категорија од членот 57 на овој закон, а Лиценцата Б за проектирање издадена пред влегувањето во сила на овој закон продолжува да важи до истекот на рокот за кој е издадена и со истата ќе може да се врши проектирање на градби од втора категорија од членот 57 на овој закон.

Лиценцата А за ревизија на проектна документација издадена пред влегувањето во сила на овој закон продолжува да важи до истекот на рокот за кој е издадена и со истата ќе може да се врши ревизија на проектна документација за градби од прва категорија од членот 57 на овој закон а Лиценцата Б за ревизија на проектна документација издадена пред влегувањето во сила на овој закон продолжува да важи до истекот на рокот за кој е издадена и со истата ќе може да се врши ревизија на проектна документација за градби од втора категорија од членот 57 на овој закон.

Лиценцата А за изведувач и Лиценцата Б за изведувач издадени пред влегувањето во сила на овој закон продолжуваат да важат до истекот на рокот за кој се издадени и со истата ќе може да се врши изведување на градби од прва категорија од членот 57 на овој закон, а Лиценцата Ц за изведувач и Лиценцата Д за изведувач издадена пред влегувањето во сила на овој закон продолжуваат да важат до истекот на рокот за кој се издадени и со истите ќе може да се врши изведување на градби од втора категорија од членот 57 на овој закон.

Лиценцата А за надзор и Лиценцата Б за надзор издадени пред влегувањето во сила на овој закон продолжуваат да важат до истекот на рокот за кој се издадени и со истите ќе може да се врши надзор над изградба на градби од прва категорија од членот 57 на овој закон а Лиценцата Ц за надзор и Лиценцата Д за надзор издадена пред влегувањето во сила на овој закон продолжуваат да важат до истекот на рокот за кој се издадени и со истите ќе може да се врши надзор над изградбата на градби од втора категорија од членот 57 на овој закон.

Член 77

Лиценцата Е за изведувач издадена пред влегувањето во сила на овој закон продолжува да важи до истекот на рокот за кој е издадена.

Носителот на Лиценцата Е за изведувач може во периодот на важењето на Лиценцата Е да поднесе барање за добивање Лиценцата А за изведувач или Лиценцата Б за изведувач согласно условите утврдени во овој закон без плаќање на надоместок.

Лиценцата А за изведувач или Лиценцата Б за изведувач од ставот (2) на овој член не се издава доколку барателот претходно не ја врати Лиценцата Е за изведувач.

Член 78

Овластување А за проектирање, Овластување А за ревизија на проектна документација, Овластување А за инженер за изведба и Овластување А за надзорен инженер издадено пред влегувањето во сила на овој закон продолжува да важи до истекот на рокот за кој е издадено и со истото ќе може да се врши проектирање, ревизија на проектна документација, раководење со изградбата и надзор над изградбата, на градби од прва категорија од членот 57 на овој закон а Овластување Б за проектирање, Овластување Б за ревизија на проектна документација, Овластување Б за инженер за изведба и Овластување Б за надзорен инженер издадено пред влегувањето во сила на овој закон продолжува да важи до истекот на рокот за кој е издадено и со истото ќе може да се врши проектирање, ревизија на проектна документација, раководење со изградбата и надзор над изградбата на градби од втора категорија од членот 57 на овој закон.

Член 79

Правните лица за проектирање, ревизија, изведување и надзор над изградбата се должни да обезбедат осигурување за одговорност за штета во осигурителна компанија во Република Македонија, најдоцна во рок од 90 дена од денот на влегувањето во сила на овој закон.

Член 80

Постапките за добивање на лиценци започнати до денот на влегување во сила на овој закон ќе продолжат според одредбите на овој закон.

Постапките за издавање на одобрение за градење започнати до денот на влегување во сила на овој закон ќе продолжат согласно со одредбите од законот по кој истите се започнати.

Член 81

Доколку за линиските инфраструктурни градби има изработен главен односно основен проект, кој е ревидиран пред влегувањето во сила на овој закон, во постапката за добивање на одобрение за градење не се доставува проект за инфраструктура.

Член 82

Органот на државна управа надлежен за вршење на работите од областа на уредување на просторот, општините, општините во градот Скопје се должни од 1 јули 2012 година постапката за добивање на одобрение за градење да ја спроведуваат на електронски начин.

Член 83

Прописот од членот 59-е на овој закон ќе се донесе во рок од шест месеци од денот на влегување во сила на овој закон.

Член 84

Со денот на влегување во сила на овој закон, престанува да важи членовите 12 и 44 став (1) точка 1 од Законот за снабдување со вода за пиење и одведување на урбани отпадни води („Службен весник на Република Македонија“ број 68/2004, 28/2006 и 103/2008).

Член 85

Се овластува Законодавно-правната комисија на Собранието на Република Македонија во рок од 30 дена од објавувањето на овој закон да утврди пречистен текст на Законот за градење.

Член 86

Овој закон влегува во сила осмиот ден од денот на објавувањето во „Службен весник на Република Македонија“.

ЛИГЈ ПËР НДРЪШИМИН ДНЕ ПЛОТËСИМИ Е ЛИГЈИТ ПËР НДËРТИМ

Нени 1

Нë Лигјин пëр ндëртим (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 130/2009 dhe 124/10), në nenin 2 pika 6 ndryshohet si vijon:

"Adaptim është kryerja e punëve të ndërtimit dhe punëve tjera në objekt ekzistues, me të cilat bëhet ndryshimi i organizimit të hapësirës në objekt, bëhet zëvendësimi i aparateve, stabilimenteve, pajisjes dhe instalimit me kapacitet të njëjtë, e me të cilat nuk ndikon në stabilitetin dhe sigurinë e objektit, nuk ndryshohen elementet konstruktive, nuk ndryshohet pamja e jashtme dhe nuk ndikohet në sigurinë e objekteve fqinje, komunikacionin dhe mbrojtjen nga zjarret dhe të mjedisit jetësor;"

Pas pikës 15 shtohet pikë e re 16, si vijon:

"16. Ndërtime infrastrukture të linjave janë rruga publike, infrastruktura hekurudhore, largpërçuesi, naftësjellësi, produktsjellësi, gazsjellësi, përçuesi i nxemjes, ujësjellësi, kanalizimi, vijat telekomunikuese dhe objekte tjera, që mund të jenë mbitokësore apo nëntokësore dhe ndërtimi i të cilave paraqet interes publik të përcaktuar me ligj;"

Pikat 16 dhe 17 bëhen pika 17 dhe 18.

Нени 2

Pas nenit 2 shtohen tre nene të reja 2-a, 2-b dhe 2-v, si vijojnë:

"Нени 2-a

Нë procedurën gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese do të zbatohen dispozitat e Ligjit për mbikëqyrje inspektuese, nëse me këtë ligj nuk është rregulluar ndryshe.

Нени 2-b

(1) Dispozitat e këtij ligji nuk kanë të bëjnë me ndërtimin e objekteve ushtarake dhe ndërtimeve me rëndësi për mbrojtjen dhe sigurinë.

(2) Ndërtimi i objekteve dhe ndërtimeve nga paragrafi (1) i këtij neni, kryhet në pajtim me rregullat nga sfera e mbrojtjes.

Нени 2-v

(1) Dispozitat e këtij ligji nuk kanë të bëjnë me ndërtimin e ndërtimeve për mbrojtje shëndetësore.

(2) Ndërtimi i ndërtimeve nga paragrafi (1) i këtij neni, kryhet në pajtim me rregullat nga sfera e shëndetësisë."

Нени 3

Нë nenin 3 paragrafi (1) fjalët: "aktvendimin për kushtet e lokacionit" zëvendësohen me fjalët: "parametrat e planit urbanistik ose dokumentacionit të planit urbanistik shtetëror, përkatësisht lokal ose projektit të infrastrukturës".

Нени 4

Нë nenin 16 paragrafi (1) fjalët: "dhe të dytë" shlyhen, ndërsa fjalët: "së tretë, të katërt dhe të pestë" zëvendësohen me fjalët: "së dytë".

Нени 5

Нë nenin 17 paragrafi (1) fjalët: "dhe të dytë" shlyhen, ndërsa fjalët: "së tretë, të katërt dhe të pestë" zëvendësohen me fjalët: "së dytë".

Нë paragrafin (2) alineja 3 fjalët: "dhe të dytë" shlyhen.

Нë paragrafin (3) alineja 3 fjalët: "së tretë, të katërt dhe të pestë" zëvendësohen me fjalët: "së dytë".

Нени 6

Нë nenin 23 paragrafi (1) fjalët: "dhe të dytë" shlyhen, ndërsa fjalët: "së tretë, të katërt dhe të pestë" zëvendësohen me fjalët: "së dytë".

Нени 7

Нë nenin 24 paragrafi (1) fjalët: "dhe të dytë" shlyhen, ndërsa fjalët: "së tretë, të katërt dhe të pestë" zëvendësohen me fjalët: "së dytë".

Нë paragrafin (2) alineja 3 fjalët: "dhe të dytë" shlyhen.

Нë paragrafin (3) alineja 3 fjalët: "së tretë, të katërt dhe të pestë" zëvendësohen me fjalët: "së dytë".

Нени 8

Нени 26 ndryshohet si vijon:

"(1) Пër kryerjen e ndërtimeve të kategorisë së parë nga neni 57 i këtij ligji, personi juridik duhet të ketë Licencë A për realizues, ndërsa për kryerjen e ndërtimeve të kategorisë së dytë personi juridik duhet të ketë Licencë B për realizues.

(2) Ме kërkesën për marrjen e licencës A për realizues të këtij ligji, personi juridik nevojitet të dorëzojë:

- dëshmi se është i regjistruar për kryerjen e veprimtarisë përkatëse dhe

- dëshmi se ka të punësuar së paku 20 persona, prej të cilëve tre me autorizim A për inxhinier për realizim dhe një person me autorizim B për inxhinier për realizim.

(3) Ме kërkesën për marrjen e licencës B për realizues, personi juridik nevojitet të dorëzojë:

- dëshmi se është i regjistruar për kryerjen e veprimtarisë përkatëse dhe

- dëshmi se ka të punësuar së paku pesë persona, prej të cilëve dy me autorizim B për inxhinierë për kryerje."

Нени 9

Нë nenin 29 paragrafi (1) në alinenë 5 lidhëza "dhe" zëvendësohet me pikë, ndërsa alineja 6 shlyhet.

Нени 10

Нë nenin 31 paragrafi (1) fjalët: "dhe të dytë" shlyhen, ndërsa fjalët: "së tretë, të katërt dhe të pestë" zëvendësohen me fjalët: "së dytë".

Нë paragrafin (2) alineja 3 fjalët: "dhe të dytë" shlyhen.

Нë paragrafin (3) alineja 3 fjalët: "së tretë, të katërt dhe të pestë" zëvendësohen me fjalët: "së dytë".

Neni 11

Neni 34 ndryshohet si vijon:

"(1) Personi juridik për kryerjen e mbikëqyrjes së ndërtimit të ndërtimeve të kategorisë së parë nga neni 57 i këtij ligji, duhet të ketë licencë A për mbikëqyrje, kurse për ndërtimet e kategorisë së dytë duhet të ketë licencë B për mbikëqyrje.

(2) Me kërkesën për marrjen e licencës A për mbikëqyrje, personi juridik nevojitet të dorëzojë:

- dëshmi se është i regjistruar për kryerjen e veprimtarisë përkatëse dhe
- dëshmi se ka të punësuar së paku katër inxhinierë, prej të cilëve dy me autorizim A për kryerje të mbikëqyrjes.

(3) Me kërkesën për marrjen e licencës B për mbikëqyrje, personi juridik nevojitet të dorëzojë:

- dëshmi se është regjistruar për kryerjen e veprimtarisë përkatëse dhe

- dëshmi se ka të punësuar së paku tre inxhinierë, prej të cilëve dy me autorizim B për kryerje të mbikëqyrjes."

Neni 12

Në nenin 35 paragrafi (1) fjalët: "dhe të dytë" shlyhen, ndërsa fjalët: "së tretë, të katërt dhe të pestë" zëvendësohen me fjalët: "së dytë".

Në paragrafin (2) alineja 3 fjalët: "dhe të dytë" shlyhen.

Në paragrafin (3) fjalët: "së tretë, të katërt dhe të pestë" zëvendësohen me fjalët: "së dytë".

Neni 13

Në nenin 36 paragrafi (1) fjalët: "aktvendimin për kushtet e lokacionit" shlyhen, ndërsa pas alinesë 1 shtohet aline e re 2 si vijon:

"- të përcaktojë nëse është bërë shënimi i ndërtimit të projektuar në terren në pajtim me nenin 82 të këtij ligji,".

Në paragrafin (3) pas fjalëve: "kushtet për ndërtim" vihet pikë, ndërsa fjalët deri në fund të fjalisë shlyhen.

Neni 14

Neni 37 ndryshohet si vijon:

"Mosharmonizimi i konstatimeve në raportin për fazë të caktuar të ndërtimit dhe/ose në raportin përfundimtar me punimet e kryera, paraqet bazë për heqjen e përkohshme të licencës për mbikëqyrje dhe autorizimit për inxhinier mbikëqyrës."

Neni 15

Pas nenit 41 shtohet nen i ri 41-a, si vijon:

"Neni 41-a

(1) Pjesëmarrësit në ndërtimin e ndërtimeve nga neni 57 i këtij ligji (investuesi, personat juridikë për projektim, revizion, kryerje dhe mbikëqyrje të ndërtimit) përgjigjen për dëmin e shkaktuar nga persona të tretë gjatë kryerjes së punës së tyre dhe obligimeve të kontraktuara.

(2) Personat juridikë për projektim, revizion, kryerje dhe mbikëqyrje të ndërtimit detyrohen që të kenë sigurim për përgjegjësi për dëm në kompani të sigurimit në Republikën e Maqedonisë, i cili me punën e tyre mund t'u shkaktohet investuesve ose personave të tretë.

(3) Shuma vjetore e siguruar për numrin e përgjithshëm të ndërtimeve për pjesëmarrësit në ndërtimin e ndërtimeve të kategorisë së parë nga neni 57 i këtij ligji, nuk mund të jetë më e vogël se 10 000 euro në kundërvlerë me denarë, ndërsa për ndërtimet e kategorisë së dytë nuk mund të jetë më e vogël se 5 000 euro në kundërvlerë me denarë.

(4) Mossigurimi për përgjegjësi për dëm në kompani të sigurimit në Republikën e Maqedonisë, paraqet bazë për heqjen e licencës personit juridik."

Neni 16

Në nenin 43 paragrafi (2) pika 1 shlyhet.

Pikat 2 dhe 3 bëhen pika 1 dhe 2.

Pika 4 shlyhet.

Pikat 5 dhe 6 bëhen pika 3 dhe 4.

Neni 17

Titulli para nenit 45 dhe neni 45 shlyhen.

Neni 18

Në nenin 45-a fjalët: "infrastrukturën për të cilën në pajtim me Ligjin për planifikim hapësinor dhe urbanistik dhe standardet dhe normativat për planifikim urbanistik, nuk formohet parcelë ndërtimore" zëvendësohen me fjalët: "ndërtimet infrastrukturore në linjë".

Pas paragrafit (1) shtohet paragrafi i ri (2), si vijon:

"(2) Projekti i infrastrukturës përmban dhe studim për vlerësimin e ndikimit të projektit mbi mjedisin jetësor, përkatësisht elaborat për mbrojtjen e mjedisit jetësor, të miratuara nga organi kompetent, nëse me rregullat nga sfera e mjedisit jetësor është paraparë përpilimi i studimit, përkatësisht elaboratit për lloj të atillë të infrastrukturës."

Neni 19

Para nenit 46 shtohet titulli si vijon "1. Projekti për punë përgatitore".

Neni 20

Në nenin 47 paragrafi (1) fjalët: "projektit ideor dhe në bazë të aktvendimit të dhënë për kushtet e lokacionit" zëvendësohen me fjalët: "ekstraktit nga plani i detajuar urbanistik ose plani urbanistik për jashtë vendbanimit ose plani urbanistik për fshat ose dokumentacioni i planit urbanistik shtetëror, përkatësisht lokal, ndërsa për ndërtimet urbanistike në linjë në bazë të projektit për infrastrukturë të përpiluar në pajtim me ligjin".

Paragrafi (3) ndryshohet si vijon:

"Projekti themelor përmban studim për vlerësimin e ndikimit të projektit mbi mjedisin jetësor, përkatësisht elaborat për mbrojtjen e mjedisit jetësor, të miratuara nga organi kompetent, nëse me rregullat nga sfera e mjedisit jetësor është paraparë përpilimi i studimit, përkatësisht elaboratit për lloj të atillë të ndërtimit."

Pas paragrafit (3) shtohen dy paragrafë të rinj (4) dhe (5), si vijojnë:

"(4) Projekti themelor për ndërtime infrastrukturore në linjë për të cilat është përpiluar projekt për infrastrukturë, nuk përmban studim për vlerësimin e ndikimit të projektit mbi mjedisin jetësor, përkatësisht elaborat për mbrojtjen e mjedisit jetësor, të miratuara nga organi kompetent.

(5) Projekti themelor përveç për ndërtime për banim individual dhe objekte publike me kapacitet për qëndrim të njëkohshëm deri në 25 persona, përmban edhe elaborat për mbrojtje nga zjarret, shpërthimet dhe materiet e rrezikshme."

Neni 21

Neni 49 shlyhet.

Neni 22

Titulli para nenit 50 dhe neni 50 shlyhen.

Neni 23

Në nenin 52 paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

"Projekti për përdorim dhe mirëmbajtje përpilohet për ndërtime të kategorisë së parë nga neni 57 i këtij ligji."

Neni 24

Në nenin 55 paragrafi (1) fjalët: "Projekti ideor, projekti themelor dhe projekti realizues" zëvendësohen me fjalën "projektet".

Neni 25

Neni 57 ndryshohet si vijon:

"(1) Ndërtime të kategorisë së parë janë: centralet bërthamore, termocentralet dhe hidrocentralet me kapacitet mbi 10 MV, largpërcuesit me nivel të tensionit mbi 35 KV, ndërtimet për prodhimin e energjisë elektrike nga burime rigjeneruese me kapacitet më të madh se 1 MW, trafostacionet mbi 35 KV, naftësjiellësit, produksjiellësit, gazsjiellësit magjistralë, autostradat, rrugët shtetërore, objektet shërbyese shoqëruese në rrugët shtetërore të përcaktuara me ligj, hekurudhat, stacionet hekurudhore në hekurudha, aeroportet, deponitë për hedhurina të parrezikshme dhe deponitë për hedhurina të rrezikshme, pendët me akumulim, ndërtimet për industri bazike dhe kimike, ndërtimet për metalurgji të zezë dhe me ngjyrë, ndërtimet për prodhimin e celulozës dhe të letrës, ndërtimet për përpunimin e lëkurës dhe të gëzofit, ndërtimet për përpunimin e kauçikut, barutit dhe të municionit eksplozues, ndërtimet për magazinimin e mjeteve shpërthyes, magazinat e derivateve të naftës, ndërtimet për sanimin e rrëshqitjes së dheut, ndërtimet të cilat mund ta rrezikojnë mjedisin jetësor, ndërtimet për nevojat e organeve shtetërore dhe agjencive dhe fondeve të themeluara nga Republika e Maqedonisë, ndërtimet për përfaqësitë diplomatike-konsullore dhe organizatat ndërkombëtare, zonat zhvillimore teknologjike industriale të formuara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe ndërtimet në këto zona, ndërtimet për arsim të lartë, observatorë, institucionet nacionale nga sfera e kulturës, ndërtimet të cilat paraqesin pasuri të patundshme kulturore dhe kompleks monumental të shpallura me ligj ose akt tjetër për mbrojtje si trashëgimi kulturore me rëndësi të veçantë ose pasuri të rëndësishme kulturore, përmendoret memoriale, qendrat telekomunikuese për pranimin e sinjaleve satelitore, ndërtimet për nevojat e vendkalimeve kufitare, sistemet rajonale të ujësjellësit dhe kanalizimit me sistem për pastrim, deponitë rajonale, ndërtimet e parapara në zonën e dy ose më shumë komunave, ndërtimet në të cilat ekzistojnë instalime për prodhimin e energjisë termike, ndërtimet në zonën e parqeve nacionale, porteve të liqeneve dhe lumenjve, stadiumet dhe sallat e sporteve me kapacitet mbi 10 000 shikues.

(2) Ndërtime të kategorisë së dytë janë: ndërtimet e dedikuara për arsimin fillor dhe të mesëm, ndërtimet nga sfera e kulturës, ndërtime për nevojat e bashkësive fetare, zonat zhvillimore teknologjike industriale të formuara nga persona juridikë dhe ndërtimet në këto zona, ndërtimet industriale, ndërtimet ekonomike, ndërtimet afariste, ndërtimet banesore-afariste, ndërtimet për banim individual, ndërtimet për banim kolektiv, ndërtimet për nevojat e agrobursave, qendrat tregtare, hotelet, qendrat rekreative, ndërtimet për veprimtari shkencore-hulumtuese, garazhet me kate, rrugët komunale, objektet shërbyese shoqëruese në rrugë komunale të përcaktuara me ligj, rrjetet dhe mjetet elektronike komunikuese, termocentralet dhe hidrocentralet me kapacitet deri në 1 MV, turbinat me erë, ndërtimet për prodhimin e energjisë elektrike nga burime rigjeneruese me kapacitet deri në 1 MW, largpërcuesit me nivel të tensionit deri në 35 KV, sistemet lokale të ujësjellësit dhe kanalizimit me sisteme për pastrim, ndërtimet që janë në funksion të mbrojtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore (qendrat informative), deponitë për hedhurina interne (hedhurina ndërtimore), objektet për magazinim, trajtim dhe/ose përpunim të hedhurinave, stacionet e autobusëve ndërrurban, kopshtet zoologjike, stadiumet dhe sallat sportive me kapacitet nën 10.000 shikues, fushat e hapura të sportit, basenet në nivel të terrenit për përdorim publik, parqet publike, parkingjet publike, teleferikët, dhe skiliftet."

Neni 26

Në nenin 58 paragrafi (1) fjalët: "dhe të dytë" shlyhen.

Në paragrafin (2) fjalët: "së tretë, të katërt dhe të pestë" zëvendësohen me fjalët: "së dytë".

Pas paragrafit (2) shtohen edhe dy paragrafë të rinj (3) dhe (4) si vijojnë:

"(3) Nëse me planin urbanistik ose dokumentacionin e planit shtetëror, përkatësisht lokal është planifikuar ndërtim me rol të shumëfishtë në të cilin janë paraparë ndërtime të kategorisë së parë dhe të dytë nga neni 57 i këtij ligji, leje për ndërtim lëshon organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës.

(4) Ekzemplari nga leja e plotfuqishme për ndërtim të cilën e miraton organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve të rregullimit të hapësirës dorëzohet në njësinë e vetadministrimit lokal në zonën e të cilës do të ndërtohet ndërtimi, në afat prej pesë ditësh nga dita e hyrjes në fuqi e lejes për ndërtim."

Neni 27

Neni 59 ndryshohet si vijon:

"(1) Procedura për lëshimin e lejes për ndërtim udhëhiqet në pajtim me dispozitat e Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative, nëse me këtë ligj nuk është rregulluar ndryshe.

(2) Për marrjen e lejes për ndërtim, investuesi paraqet kërkesë me shkrim në organin kompetent nga neni 58 i këtij ligji, me dokumentacionin në vijim:

- ekstrakt nga plani i detajuar urbanistik ose plani urbanistik për jashtë vendbanimit ose plani urbanistik për fshat ose dokumentacioni i planit urbanistik shtetëror, përkatësisht lokal, kurse për ndërtimet infrastrukturore në linjë, projekt për infrastrukturë të verifikuar nga organi kompetent,

- projekt arkitekturor-urbanistik të verifikuar nga organi kompetent, nëse me planin urbanistik ose dokumentacionin e planit urbanistik shtetëror, përkatësisht lokal është paraparë përpilimi i këtij projekti,

- projekt themelor në tre ekzemplarë me raport për revizion të projektit themelor ose raport me shkrim me pëlqim për nostrifikimin e projektit themelor, nëse ai është përpiluar jashtë vendit,

- dëshmi për të drejtën e ndërtimit dhe

- elaborat gjeodezik për të dhënat numerike për tokën ndërtimore.

(3) Nëse është paraqitur kërkesë për leje për ndërtim për objekte shërbyese shoqërore në rrugë komunale, përkatësisht shtetërore të përcaktuara me ligj, krahas provave nga paragrafi (2) i këtij neni, kërkuesi dorëzon edhe aktvendim për ndryshim të përhershëm të regjimit të komunikacionit nga organi kompetent.

(4) Nëse është paraqitur kërkesë për leje për ndërtim të cilat paraqesin trashëgimi të patundshme kulturore dhe komplekse monumentale të shpallura me ligj ose akt tjetër për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, krahas dëshmive nga paragrafi (2) i këtij neni, dorëzohet edhe leje konservimi, e lëshuar nga Drejtoria për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore.

(5) Nëse është paraqitur kërkesë për leje për ndërtim për ndërtime për prodhimin e energjisë elektrike dhe termike, krahas dëshmive nga neni (2) i këtij neni dorëzohet edhe autorizim për ndërtimin e ndërtimeve për prodhimin e energjisë elektrike dhe termike nga organi kompetent.

(6) Nëse është paraqitur kërkesë për leje për ndërtim të rrjeteve dhe mjeteve elektronike komunikuese, krahas dëshmive nga paragrafi (2) i këtij neni dorëzohet edhe notifikim për bartjen e të dhënave elektronike, të lëshuar nga Agjencia për Komunikime Elektronike.

(7) Nëse është parashtruar kërkesë për leje për ndërtim të deponive për hedhurina të rrezikshme, deponive për hedhurina të pa rrezikshme dhe deponie për hedhurna interne, krahas dëshmimeve nga paragrafi (2) i këtij neni dorëzohet edhe aktvendim me të cilin lejohet themelimi i deponisë, të lëshuar nga organi kompetent.

(8) Organi kompetent nga neni 58 i këtij ligji, detyrohet që në afat prej 15 ditësh nga pranimi i kërkesës, ta shqyrtojë dokumentacionin e paraqitur dhe të përcaktojë nëse ai është i kompletuar, nëse projekti themelor është përpiluar në pajtim me rregullat për projektim, planin urbanistik apo dokumentacionin e planit urbanistik shtetëror apo lokal ose projektin e infrastrukturës dhe nëse kërkuesi është bartës i vetëm i të drejtës për ndërtim.

(9) Nëse dokumentacioni i dorëzuar është i kompletuar dhe janë plotësuar kushtet nga paragrafi (8) i këtij neni, organi kompetent detyrohet që në afatin nga paragrafi (8) i këtij neni, ta verifikojë projektin themelor dhe t'i dorëzojë kërkuetit njoftim me llogaritje për pagesën e kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore. Për ndërtimet e kategorisë së parë, organi kompetent pas verifikimit të projektit themelor, e dorëzon atë në komunën përkatëse për përpilimin e llogaritjes së kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore.

(10) Nëse dokumentacioni i dorëzuar nuk është i kompletuar dhe/ose nuk janë përmbushur kërkesat nga paragrafi (8) i këtij neni, organi kompetent detyrohet që në afatin nga paragrafi (8) i këtij neni, të miratojë konkluzion për ndërprerjen e procedurës dhe ta ngarkojë kërkuetin që t'i mënjanojë mangësitë e konstatuara dhe ta plotësojë kërkesën në afat prej 15 ditësh nga pranimi i konkluzionit.

(11) Nëse kërkueti nuk i mënjanon mangësitë e konstatuara dhe nuk e plotëson kërkesën në afatin nga paragrafi (10) i këtij neni, organi kompetent detyrohet të miratojë aktvendim për refuzimin e kërkesës për leje për ndërtim në afat prej shtatë ditësh nga skadimi i afatit të fundit për plotësim, e nëse kërkueti i mënjanon parregullsitë e konstatuara dhe e plotëson kërkesën në afatin nga paragrafi (10) i këtij neni, organi kompetent detyrohet t'i dorëzojë kërkuetit njoftim me llogaritje për pagesën e kompensimit për rregullimin e tokës në afat prej dy ditësh nga kompletimi i dokumentacionit.

(12) Leja për ndërtim nuk mund të jepet, nëse nuk është paguar kompensimi për rregullimin e tokës ndërtimore, përveç nëse investuesi dhe komuna lidhin marrëveshje për pagesën e kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore në këste, ose lidhin marrëveshje me të cilën përcaktohet se investuesi do ta rregullojë tokën me shpenzime personale, ose është miratuar akt në bazë të të cilit investuesi lirohet nga pagesa e kompensimit ose investuesi ka dorëzuar garanci bankare për pagesën e kompensimit ose investuesi të ketë vendosur hipotekë në dobi të komunës.

(13) Leja për ndërtim lëshohet në afat prej pesë ditëve të punës nga dorëzimi i dëshmisë për kompensim të paguar për rregullimin e tokës ndërtimore, përkatësisht nga dita e lidhjes së marrëveshjes për mënyrën e pagesës së kompensimit ose marrëveshje me të cilën, përcaktohet se investuesi do ta rregullojë tokën me shpenzim personal, përkatësisht nga dita e miratimit të aktit në bazë të të cilit investuesi lirohet nga pagesa e kompensimit ose nga dita e dorëzimit të garancisë bankare për pagesë të kompensimit ose dorësimin të dëshmisë për hipotekë të vendosur në dobi të komunës.

(14) Formën dhe përmbajtjen e kërkesës për leje për ndërtim, i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës.

(15) Organi kompetent nga neni 58 i këtij ligji, i cili e ka lëshuar lejen për ndërtim, detyrohet që investuesit t'i dorëzojë llogaritje për pagesën e shpenzimeve për regjistrimin e objektit në librat publike të patundshmërive në afat prej shtatë ditëve të punës nga dita e lëshimit të lejes për ndërtim.

(16) Organi kompetent në procedurën e lëshimit të lejes për ndërtim nuk mund të kërkojë nga kërkueti dokumentacion tjetër, përveç dokumentacionit të paraparë me këtë ligj."

Neni 28

Pas nenit 59 shtohen shtatë nene të reja 59-a, 59-b, 59-v, 59-g, 59-d, 59-gj dhe 59-e si vijojnë:

"Neni 59-a

Si dëshmi për të drejtën për ndërtim sipas këtij ligji konsiderohet:

- aktzotërimi me të drejtë të shënuar të pronësisë ose të drejtë të qirasë afatgjate ose të drejtë servituti të tokës ndërtimore,

- marrëveshja për bartjen e të drejtës për ndërtim të tokës për ndërtim në fjalë,

- marrëveshja për koncesion,

- vendimi i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë me të cilin organ shtetëror, agjencia ose fondi i themeluar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë ose njësi e vetëadministrimit lokale, e kanë fituar të drejtën për ndërtim,

- marrëveshja me bashkësinë e pronarëve të pjesëve të posaçme të objektit ose pëlqimi me shkrim nga shumica e pronarëve të pjesëve të posaçme të objektit që paraqesin më shumë se gjysmën e sipërfaqes së përgjithshme të objektit me aktzotërimi për pjesët e posaçme të objektit, nëse bëhet fjalë për ndërtim shtesë dhe mbindërtim të ndërtesave në pronësi me kate dhe

- aktzotërimi me të drejtë të shënuar të pronësisë së Republikës së Maqedonisë, nëse bëhet fjalë për ndërtim të ndërtimeve infrastruktururore të linjave.

Neni 59-b

Për ndërtime të dedikuara për banim individual me sipërfaqe të zhvilluar bruto deri në 300 m², nuk është i detyrueshëm revizioni i projektit themelor dhe mbikëqyrja mbi ndërtimin e ndërtimit, kurse realizuesi detyrohet që të japë deklaratë të verifikuar në noter, me përgjegjësi të plotë materiale dhe penale, me të cilën do të vërtetojë se objekti është ndërtuar në pajtim me lejen për ndërtim dhe projektin themelor ose projektin e gjendjes së realizuar.

Neni 59-v

(1) Pas pranimi të kërkesës për leje për ndërtim, organi kompetent nga neni 58 i këtij ligji, detyrohet që në afat jo më të gjatë se një ditë e punës, të dorëzojë kërkesë me shkrim në subjektet përgjegjëse për infrastrukturën elektroenergjetike, të ujësjellësit dhe kanalizimit, që të kryejnë inspektim në projektin themelor, në afat prej pesë ditësh nga pranimi i kërkesës për inspektim.

(2) Subjekti kompetent për infrastrukturën elektroenergjetike detyrohet që të kryejë inspektim në projektin themelor dhe në afat prej pesë ditësh nga pranimi i kërkesës për inspektim, të dorëzojë mendim nëse objekti për të cilin është dorëzuar kërkesa për miratim për ndërtim mund të lidhet në sistemin elektroenergjetik përkatës.

(3) Subjektet kompetente për infrastrukturën e ujësjellësit dhe të kanalizimit në afat prej pesë ditësh nga dita e pranimi të kërkesës për inspektim, detyrohen që të kryejnë inspektim në projektin themelor dhe të prononcohen në procesverbal nëse janë plotësuar kushtet hidroteknike, përkatësisht të japin vërejtje, nëse ato nuk janë përmbushur. Procesverbali nënshkruhet nga ana personit zyrtar dhe përfaqësuesit të subjektit, ndërsa ekzemplar nga ai, i dorëzohet kërkuetit i cili është i detyruar që të veprojë sipas vërejtjeve të dhëna në afatin nga neni 59 paragrafi (10) i këtij ligji.

(4) Nëse me projektin themelor parashihet lidhja e ndërtimit për të cilin është parashtruar kërkesë për leje për ndërtim, në infrastrukturën për përcim të nxehtësisë dhe të gazsjellësit, organi kompetent nga neni 58 i këtij ligji, detyrohet që të dorëzojë kërkesë me shkrim në subjektet kompetente për infrastrukturën për përcim të nxehtësisë dhe të gazsjellësit, të kryejnë inspektim në projektin themelor, në afat prej pesë ditësh nga dita e pranimit të kërkesës për inspektim. Subjektet kompetente për infrastrukturën për përcim të nxehtësisë dhe të gazsjellësit në afat prej pesë ditësh nga dita e pranimit të kërkesës për inspektim, detyrohen që të kryejnë inspektim në projektin themelor dhe të prononcohen në procesverbal nëse janë plotësuar kushtet për lidhje në infrastrukturën për përcim të nxehtësisë dhe të gazsjellësit, përkatësisht të japin vërejtje, nëse ato nuk janë përmbushur. Procesverbali nënshkruhet nga ana e personit zyrtar dhe përfaqësuesit të subjektit, ndërsa ekzempër nga ai, i dorëzohet kërkuessit i cili është i detyruar që të veprojë sipas vërejtjeve të dhëna në afatin nga neni 59 paragrafi (10) i këtij ligji.

(5) Nëse bëhet fjalë për ndërtim të magazinave për magazinimin e materieve shpërthyes, magazinave, depove ose rezervoareve për maganizimin e lëngjeve dhe gazrave djegëse, vendeve për mbushje dhe derdhje, stacionit për furnizim me karburant, naftsjellësit ose gazsjellësit duke e përfshirë deponë, stabilimentin ose aparatin që është e lidhur teknologjikisht me naftësjellësin ose gazsjellësin, dorëzohet kërkesë me shkrim për inspektim të projektit themelor edhe në organin e administratës shtetërore kompetente për kryerjen e punëve nga sfera e punëve të brendshme, i cili është i detyruar që të kryejë inspektim dhe në afat prej pesë ditësh nga dita e pranimit të kërkesës për inspektim të japë pëlqim ose të japë vërejtje në procesverbal, nëse nuk janë përmbushur kushtet për pëlqim. Procesverbali nënshkruhet nga ana personit zyrtar dhe përfaqësuesit të organit, ndërsa ekzempër nga ai, i dorëzohet kërkuessit i cili është i detyruar që të veprojë sipas vërejtjeve të dhëna në afatin nga neni 59 paragrafi (10) i këtij ligji.

(6) Nëse bëhet fjalë për ndërtim të ndërtimeve për të cilat projekti themelor në pajtim me nenin 47 paragrafi (5) të këtij ligji, përmban edhe elaborat për mbrojtje nga zjarret, shpërthimet dhe materiet e rrezikshme, dorëzohet kërkesë me shkrim për inspektim në projektin themelor edhe në Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim, e cila është e detyruar që të kryejë kontroll dhe në afat prej pesë ditësh nga dita e pranimit të kërkesës për inspektim të japë pëlqim ose të japë vërejtje në procesverbal, nëse nuk janë përmbushur kushtet për pëlqim. Procesverbali nënshkruhet nga ana personit zyrtar dhe përfaqësuesit të Drejtorisë, ndërsa ekzempër nga ai, i dorëzohet kërkuessit i cili është i detyruar që të veprojë sipas vërejtjeve të dhëna në afatin nga neni 59 paragrafi (10) i këtij ligji.

(7) Nëse bëhet fjalë për ndërtim të rrjeteve dhe mjeteve elektronike komunikuese, dorëzohet kërkesë me shkrim për inspektim në projektin themelor edhe në Agjencinë për Komunikime Elektronike, e cila është e detyruar që të kryejë inspektim dhe në afat prej pesë ditësh nga dita e pranimit të kërkesës për inspektim të japë pëlqim ose të japë vërejtje në procesverbal, nëse nuk janë përmbushur kushtet për pëlqim. Procesverbali nënshkruhet nga ana personit zyrtar dhe përfaqësuesit të Agjencisë, ndërsa ekzempër nga ai, i dorëzohet kërkuessit i cili është i detyruar që të veprojë sipas vërejtjeve të dhëna në afatin nga neni 59 paragrafi (10) i këtij ligji.

(8) Nëse subjektet nga paragrafët (2), (3), (4), (5), (6) dhe (7) të këtij neni, nuk veprojnë në pajtim me këtë nen, konsiderohet se nuk kanë vërejtje dhe nëse për shkak të mosveprimit të tyre në të ardhmen shkaktohen dëme, obligimi për kompensim të dëmit do të jetë në ngarkim të subjektit mosveprimi i të cilit e ka shkaktuar dëmin.

Neni 59-g

Kushtet mbrojtëse-konservuese në procedurën për lëshimin e lejes për ndërtim, përcaktohen vetëm nëse në planin urbanistik nuk ka inkomporuar baza mbrojtëse konservuese.

Neni 59-d

(1) Organi kompetent i cili e ka lëshuar lejen për ndërtim, detyrohet që në afat prej tre ditësh nga dita e hyrjes në fuqi e lejes për ndërtim, të dorëzojë ekzemplar nga leja, me ekzemplar nga projekti themelor i verifikuar ose projekt të gjendjes së realizuar në organin kompetent për mbajtjen e librit publik për regjistrimin e të drejtave të patundshmërive për regjistrim në librin publik në të cilin është regjistruar e drejta mbi tokën dhe ekzemplar inspektorit kompetent të ndërtimit.

(2) Kur leja për ndërtim u lëshohet më tepër investuesve, në leje shënohen të gjithë investuesit në pjesë ideale, në bazë të veprës juridike për rregullimin e të drejtave të ndërsjella dhe obligimeve për ndërtim, të verifikuara në noter.

(3) Dispozitat e këtij ligji kanë të bëjnë edhe me procedurën e lëshimit të lejes për ndërtim shteteve të huaja, për nevojat e përfaqësive të tyre diplomatike konsullore, nëse me marrëveshje ndërkombëtare nuk është rregulluar ndryshe.

Neni 59-gj

(1) Nëse organi kompetent nga neni 58 i këtij ligji, nuk lëshon leje për ndërtim, përkatësisht nuk e refuzon kërkesën për leje për ndërtim në afatin e përcaktuar në nenin 59 të këtij ligji, kërkuessit ka të drejtë që në afat prej tre ditësh nga skadimi i këtij afati, t'i parashtrojë kërkesë funksionarit i cili udhëheq me organin, përkatësisht personit udhëheqës të organit i cili vepron për kërkesën për leje për ndërtim, për miratimin e aktvendimit me të cilin do të konstatohet se kërkesa për leje për ndërtim është e pranuar.

(2) Funksionari i cili udhëheq me organin, përkatësisht personi udhëheqës i organit i cili vepron për kërkesën për leje për ndërtim, pasi do të konstatojë se kërkesa për leje për ndërtim nuk përmban mangësi formale, është dorëzuar dokumentacioni i përcaktuar në nenin 59 të këtij ligji, ka kaluar afati për lëshimin e lejes për ndërtim, përkatësisht miratimin e aktvendimit për refuzimin e kërkesës, të përcaktuar në nenin 59 të këtij ligji dhe kërkesa nga paragrafi (1) i këtij neni, është me kohë, detyrohet që të miratojë aktvendim më së voni në afat prej pesë ditësh nga pranimi i kërkesës me të cilin do të konstatohet se kërkesa për leje për ndërtim është pranuar.

(3) Nëse kompensimi për rregullimin e tokës ndërtimore nuk është paguar, aktvendimi me të cilin konstatohet se kërkesa për leje për ndërtim është pranuar, lëshohet pas pagesës së kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore ose pas rregullimit të pagesës së kompensimit në pajtim me nenin 59 paragrafi (13) të këtij ligji.

(4) Nëse funksionari i cili udhëheq me organin, përkatësisht personi udhëheqës i organit, nuk miraton aktvendim në pajtim me paragrafin (2) të këtij neni, kërkuessit ka të drejtë që të ngritë kontest administrativ para gjykatës kompetente.

Neni 59-e

